

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 8, neni 20 paragrafi 1 alineja 11, të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14) dhe neni 15 paragrafi 1 alineja 7 nga Rregullorja e punës së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale nr. 01-4351/1 nga data 29.08.2014, e në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr. 02-5903/7 nga data 04.12.2014

Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, në mbledhjen e 20-të të mbajtur më 04.12.2014-të, miratoi:

RREGULLORE PËR NIVELIZIMIN E TONIT TË PËRMBAJTJES AUDIOVIZIVE

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Kjo rregullore ka të bëjë me punën e radiodifuzerëve që emetojnë program televiziv (në tekstin e mëtejme radiodifuzerët) dhe i përcakton nivelet e lejueshme maksimale të tonit dhe nivelin e lejueshëm të zhurmës së përmbajtjeve audiovizuale që dërgohen për emetim nga ana e radiodifuzerëve deri te operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik (operator të multipleksëve digjitale terestriale dhe operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik që përdorin resurse të pakufizuara).

NIVELI I ZHURMËS DHE FORCËS SË TONIT

Neni 2

Në aspekt të nivelit të zhurmës që paraqitet në studiot ku prodhohet programi nga instalime të ndryshme elektroakustike (mikrofona, përforcues, pajisjet e incizimit dhe reproduksionit etj), radiodifuzerët duhet ti përmbahen rekomandimit EBU R-128 të Unionit Evropian radiodifuziv (EBU – European Broadcasting Union), si dhe të udhëzimeve teknike EBU TECH 3343 и EBU TECH 3344 që janë në lidhje me implementimin e rekomandimit EBU R-128.

Neni 3

Në aspekt të forcës së tonit, gjatë përpunimit të materialeve audiovizuale kur punohet në teknologji analoge, forca e tonit duhet të jetë prej -6 dB deri -4 dB.

Neni 4

Në aspekt të forcës së tonit, gjatë përpunimit të materialeve audiovizuale kur punohet në teknologji digjitale, forca e tonit duhet të jetë prej -18dB dB deri -6dB dB.

Neni 5

Forca e tonit të materialit audiovizuel që nga ana e radiodifuzerit dërgohet për emetim, duhet të jetë 0 dB (zero VU) në shkallën e VU metrit (Volume Unit Meter).

Forca e tonit të materialit audiovizuel që nga ana e radiodifuzerit dërgohet për emetim, duhet të jetë 0 dB (zero PM) në shkallën e PPM metrit (Peak Programme Meter).

Neni 6

Gjatë emetimit të lajmeve dhe komunikimeve komerciale audiovizuele, në aspekt të forcës së tonit të materialit audiovizuel, mund të ketë lëshime, me ç'rast forca e tonit mund të jetë 10% në aspekt të vlerave të përcaktuara në nenin 5 të kësaj Rregullore.

DISPOZITAT PËRMBYLLËSE

Neni 7

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e ardhshme pas ditës së publikimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë"

Nr. 01-5981/1

04.12.2014

Shkup

**Agjencia për shërbime
mediatike audio dhe audiovizuele**

Kryetar i Këshillit

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v